



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:126234

Datë: 24.09.2020

Numri i dokumentit: 01138280

C.nr.102/18

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil si gjykatë civile e shkallës së parë, me gjyqtarin Veton Ademaj, në çështjen juridike – kontestimore të paditëses E. SH., nga Peja, të cilën e përfaqëson M. K.-juriste, nga SSH sipas autorizimit, kundër të paditurës QKMF Peje, të cilën e përfaqëson zyrtari ligjor A. Z., sipas autorizimit, për kompensimin e pagave jubilarë dhe percjellese, vlera e kontestit 2,592.24 €, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor në prezencë të autorizuarit të paditëses, e në mungesë të autorizuarit të të paditurës, me datë 21.09.2020, ndërsa me datë 24.09.2020, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses E. SH., nga Peja, ashtu që **DETYROHET** e paditura QKMF Pejë, që paditëses E. SH., nga Peja, në emër të shpërblimit jubilar t'ia kompensoj shumën e tri neto pagave bazë në shumën prej 1.296.12 euro, dhe në emër të shpërblimit për percjellje në pension shumën e tri pagave të fundit neto, në shumën prej 1.296.12 euro, e që në total i bie shuma prej 2592.24 euro.

II. DETYROHET e paditura QKMF Pejë, që paditëses shumën e cekur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguaj me kamatë ligjore prej 8 % në vit, e cila do të llogaritet nga data e marrjes së këtij aktgjykimi datë 24.09.2020, si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 140 Euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja E. SH., nga Peja, ka parashtruar padi për kompensimin e pagave për percjellje në pension dhe shpërblimi jubilar me datë 02.02.2018, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të tri pagave percjellese me rastin e pensionimit me dt. 05.02.2018, t'ia paguaj shumën prej 1.296.12 euro, dhe në emër të tri pagave jubilarë nga përvoja e punës t'ia paguaj shumën prej 1.296.12 euro, e që gjithsej i bie shumën prej 2592.24 euro, si dhe kamatën ligjore prej 8% duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

I autorizuari i të paditurës me dt. 05.12.2019, ka paraqitur përgjigje në padi me të cilën në tërësi e ka kontestuar padinë e paditëses me arsyetimin se beneficioniet të cilat ju takojnë punëtorëve shëndetësor pas pensionimit janë të rregulluara me Kontratën Kolektive Sektoriale e jo në bazë të Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, sikurse pretendohet në padi. Ku sipas Kontratës Kolektive Sektoriale të vitit 2015, nuk janë parashikuar beneficionet e pretenduara

nga paditësja, këto beneficione janë parashikuar me Kontratën Kolektive Sektoriale të vitit 2018 e cila ka hy në fuqi nga data 11.06.2018, ndërsa paditëses marrëdhënia e punës i është ndërprerë me dt. 05.02.2017, para hyrjes në fuqi të kësaj kontrate. Gjykatës i ka propozuar që padinë e paditëses ta refuzon si të pabazuar.

Paditësja, përmes të autorizuarës se saj gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesës se saj, duke shtuar se paditësja ishte e punësuar në QKMF Pejë, si infermiere, ku ka punuar nga viti 1972 deri në vitin 2017, ku i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të pensionimit. Në bazë të dispozitave të marrëveshjes së përgjithshme kolektive të Kosovës, respektivisht nenit 52 dhe 53, ku parashihet se pagesa e pagave jubilarë dhe të tri pagave përcjellëse pas pensionimit. Kërkojmë që e paditura t'ia paguaj paditëses E. SH. 3 paga jubilarë në vlerë prej 1296.12 euro dhe 3 paga përcjellëse me rastin e pensionimit në vlerë prej 1296.12 euro, e të cilat së bashku bëjnë 2592.24 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga momenti i dorëzimit të padisë deri në vendimin përfundimtar të gjykatës, i propozojmë gjykatës që padinë dhe kërkesën e saj ta aprovoj si të bazuar pasi që nga provat e administruara është vërtetuar në tërësi si baza juridike ashtu edhe kërkesa e padisë. shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për taksë për padi dhe për ekspertizë financiare.

I autorizuari i të paditurës gjatë shqyrtimit kryesor të dt.11.02.2020, ka deklaruar se në tërësi mbes pranë përgjigjes në padi, duke qartësuar se marrëveshja e përgjithshme kolektive e Kosovës me të cilën paditësja ka pretenduar për të drejtën e pagesës të pagave jubilarë dhe tri pagave përcjellëse pas pensionimit, është parashikuar në marrëveshje mirëpo neni 4, i kësaj marrëveshje parashikon që degët e sindikatave të veprimtarive jo ekonomike (shërbime civile, publike dhe ndërmarrje publike), lidhin kontratë të posaçme me punëdhënësit e tyre (Ministri përkatëse, atë të Administratës Publike, Arsimit, Shëndetësisë, etj.), në pajtim me specifikat e tyre. Nisur nga kjo dispozitë konsiderojmë se të drejtat e punëtorëve shëndetësor për pagat jubilarë dhe përcjellëse, kompensimin e tyre duhet të rregullohen me kontratën kolektive sektoriale. Në bazë të cekurave me lartë konsiderojmë se gjykata ishte dashtë të ketë parasysh këtë dispozitë ligjore dhe të vendos në mënyrë të drejtë për çështjen.

E paditura për seancën e shqyrtimit kryesor të dt. 21.09.2020, ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt nga ana e gjykatës, mungesën nuk e ka arsyetuar me çka gjykata sipas propozimit të autorizuarës se paditëses e në mbështetje të dispozitës së nenit 423.4, të LPK-së, shqyrtimin kryesor e mbajti pa praninë e palës së paditur.

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve gjykata ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar këto prova: Letërnjoftimin e paditëses E. SH., me nr.personal ..., vendimin e lëshuar nga QKMF Pejë, me dt. 05.02.2017 me nr.163/1, kërkesën e paditëses drejtuar Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale 1275/1 të dt. 23.12.2016, kërkesën e paditëses drejtuar drejtorit të QKMF-së Pejë me dt. 26.01.2017, me nr.prot.187/1, lista e pagave e lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës me dt. 24.01.2017, 21.12.2016 dhe 24.11.2016, pasqyrën e xhirlogarisë bankare të paditëses lëshuar nga "P..." e dt. 30.01.2018, librezën e punës e lëshuar nga Kuvendi i Komunës së Pejës, me nr. të regjistrimit ..., e dt. 04.10.1972 (2 fleta), vërtetimin e lëshuar nga QKMF në Pejë i dt.01.02.2018 me nr. të protokollit 112/1, kontrata e punës e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës me nr. 593, e dt. 31.12.2009, kontrata e punës lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës me nr.593, e dt. 05.01.2007, kontrata e punës e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës me nr.78/04, nga Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale e dt.23.13.2003, vendimi mbi caktimin në punë si dhe kompensimin për të ardhurat personale e lëshuar për paditësen nga Qendra Medicinale – Dispanseri për Shëndet dhe Fëmijë me nr.6/539 e dt.22.10.1974, vendimin mbi caktimin në punë

si dhe kompensimin për të ardhurat personale e lëshuar për paditësen nga Qendra Medicinale – Mbrojtja shëndetësore e grave dhe fëmijëve me nr.6, e dt.13.04.1975, njoftimi i lëshuar nga trusti i kursimeve pensionale të Kosovës me dt. 23.02.2017, për paditësen E. SH., kontrata e punës për kohë të pacaktuar me nr.593/12 e dt. 31.12.2012 e lidhur ndërmjet palëve kontraktuese paditëses dhe të paditurës, kartela bankare e lëshuar nga “N...” për paditësen E. SH., Ekspertiza financiare e punuar nga eksperti gjyqësor G. G., me dt. 10.03.2020, gjykata me rastin e vendosjes mori parasysh edhe deklaratimet e të autorizuarve të ndërgjyqësve.

Gjykata pas vlerësimit të secilës provë veç e veç, dhe të gjithave së bashku në lidhmëri me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga vërtetimi i lëshuar nga QKMF në Pejë, me nr.protokoli 112/1, i dt. 01.02.2018, vërtetohet se paditësja E. SH., ka qene në marrëdhënie pune në kuadër të Qendrës Medicinale respektivisht QKMF-së në Pejë, në kryerjen e punëve dhe detyrave të punës Infermiere e Përgjithshme, dhe atë duke filluar nga dt. 07.10.1972, dhe ka mbi 44 vite përvojë pune.

Nga kontratat e punës e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës me nr. 593, e dt. 31.12.2009, me nr.593, e dt. 05.01.2007, me nr.78/04, vërtetohet fakti se paditësja E. SH., ka lidhur kontratë pune me të paditurën Komunën e Pejës – Qendrën e Mjekësisë Familjare (QKMF), ku ka qenë e punësuar si infermiere e përgjithshme.

Nga Kërkesa e paditëses e dt. 23.12.2016, drejtuar Drejtorisë të Drejtoratit për Mirëqenie Sociale në Pejë, dhe kërkesës se dt. 26.01.2017, drejtuar Drejtorit të QKMF Pejë, vërtetohet fakti se paditësja i është drejtuar Drejtoratit për Mirëqenie Sociale dhe Drejtorit të QKMF-së në Pejë, me kërkesë për kompensimin e tri pagave jubilarë nga përvoja e punës dhe tri pagave me rastin e pensionimit. Dhe se nga këto institucione nuk ka marr asnjë përgjigje.

Nga vendimi i dt. 05.02.2017, me nr. 163/1, i lëshuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Pejë, vërtetohet fakti paditëses E.SH., e caktuar në vendin e punës Infermiere e Përgjithshme, në kuadër të QKMF-së në Pejë, i ndërprehet marrëdhënia e punës përfundimisht prej dt. 05.04.2017, për shkak te pensionimit.

E paditura nuk kishte kontestuar lartësinë e viteve të përvojës së punës së paditëses, gjithashtu nuk ishte kontestuese së paditësja ka qenë e punësuar në QKMF në Pejë, mirëpo kontestuese ishte baza juridike e kërkesë padisë, sa i përket pagave jubilarë.

Gjykata gjen së baza juridike e kërkesëpadisë së paditëses ka mbështetje në dispozitat ligjore si në vijim:

Në nenin 4, par.2 të Ligjit të Punës (Nr.03/L-212) i cili ka qenë në fuqi në kohën e pensionimit të paditëses, gjithashtu edhe tani është në fuqi, parashihet se “*Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj*”. Ndërsa në nenin 67 të këtij ligji parashihet se “*1.Kontrata e punës sipas fuqisë ligjore ndërpritet: 1.4. kur i punësuarit e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç*”. Po ashtu në nenin 90 të këtij ligji parashihet se “*1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet:1.1. orG.zatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. orG.zatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë orG.zata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në:2.1. nivel të vendit,2.2. nivel të degës,2.3. nivel të ndërmarrjes.3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në*

formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuara në këtë ligj”.

Gjithashtu, në nenin 52, të Marrëveshjes se Përgjithshme të Kosovës (MPKK) e cila është në fuqi që nga data 01.01.2015, parashihet se *“1. I punësuar, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një paga mujore të tij; 1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. 2.Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. 3.Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”,* ndërsa me nenin 53, te të njëjtës marrëveshje parashihet se *“I punësuar, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt te fundit”.*

Me qëllim të vërtetimit të lartësisë së kërkesë padisë, sipas propozimit të autorizuarës së paditëses gjykata ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare e cila është punuar nga eksperti financiar gjyqësor G. G., me datë 10.03.2020, ku nga ekspertiza e tillë financiare, është vërtetuar për paditësen E. SH., lartësia e shumes për pagat jubilarë dhe për tri pagat përcjellëse pas pensionimit, dhe atë në emër të shpërblimit jubilar t’ia kompensoj shumën e tri neto pagave baze në shumën prej 1.374,59 euro dhe në emër të shpërblimit për përcjellje në pension shuma e tri neto pagave te fundit në shumën prej 1.374,59 euro, e që në total i bie shuma prej 2.749,18 euro. (mirëpo paditësja e ka zvogëluar kërkesën dhe atë në emër të kompensimit për paga jubilarë në shumën prej 1.296,12 euro dhe për paga përcjellëse me rastin e pensionimit në shumën prej 1.296,12, e në shumë të përgjithshme prej 2.592,24 euro). Andaj gjykata vendosi si në pikën I, të dispozitivit të aktgjykimit lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë pasi që është e lidhur me kërkesën e palëve, e kjo gjen mbështetje edhe dispozitën e nenit 2.1, të LPK-së, me të cilin parashihet se *“në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”.*

Në mes palëve ndërgjyqësve nuk ishte kontestuese se paditësja tek e paditura kanë qenë në marrëdhënie pune, të caktuar në vendin e punës – sipas kontratave të punës me QKMF në Pejë, dhe se të njëjtës i është ndërprerë marrëdhënia e punës, për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare (pensionimit).

Po ashtu edhe pretendimet e palës së paditur se beneficioniet të cilat ju takojnë punëtorëve shëndetësor pas pensionimit janë të rregulluara me Kontratën Kolektive Sektoriale e jo në bazë të Kontratës se Përgjithshme Kolektive të Kosovës, një gjë e tillë nuk qëndron, sepse Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës është akt i përgjithshëm juridik i cili ka fuqi dhe zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës, për të dy nivelet atë lokal dhe qendror dhe për të dy sektorët atë privat dhe publik që kanë të bëjnë me shëndetësinë në Kosovë.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet si e bazuar. Kjo ngase në bazë të provave të administruara është vërtetuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, të njëjtit me vendim të të paditurës i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionit. Pasi që paditësi në procedurë

administrative nga e paditura nuk i është dhënë kompensimi i pagave përcjellëse dhe pagave jubilarë me rastin e shkuarjes në pension, i njëjti ka kërkuar realizimin e kompensimit të pagave përcjellëse dhe jubilarë në procedurë gjyqësore, e që një e drejtë e tillë ishte e argumentuar dhe e bazuar në dispozitat e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, andaj gjykata e detyroi të paditurën, që paditëses t'ia paguajë pagat në emër të shpërblimit jubilar sipas përvojës së punës që ka arritur deri në momentin e pensionimit, si dhe pagat për përcjellje në pension, në lartësi të tri pagave të fundit të cilat i kanë realizuar këtu paditësja, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë mori parasysh ekspertizën financiare të punuar nga eksperti financiar-gjyqësor dhe të njëjtës ia fali besimin në tërësi, pasi që ishte në harmoni edhe me provat e tjera në shkresat e lëndës, gjithashtu edhe provave tjera të lartcekura gjykata ua fali besimin e plotë, ngase gjeti se të njëjtat janë të besueshme dhe përputhen në tërësi me gjendjen faktike të vërtetuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe kundërshtimet e tjera të palës së paditur, si dhe provat tjera nga shkresat e lëndës, mirëpo të njëjtat ishin pa ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridiko-kontestimore.

Në lidhje me kamatën ligjore gjykata nuk e aprovoi kërkesën e palës paditëse që kamata ligjore të paguhet nga data e paraqitjes së padisë e që është data 02.02.2018, mirëpo vendosi që e paditura duhet ta paguajë kamatën për kompensimin për pagat përcjellëse dhe jubilarë, si në pikën II të dispozitivit, pasi që gjykata ka vlerësuar se kamata rrjedh nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, e që në rastin konkret është data 24.09.2020, kjo bazuar në nenin 382 parag.1 dhe 2 të LMD-së, pasi që pala e paditur nga data e marrjes së këtij aktgjykimi është në dijeni për lartësinë e kompensimit në emër të pagave përcjellëse dhe jubilarë të paditësit dhe e njëjta nga data e lartcekur bie në vonesë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449, 452, 453.1 dhe 463 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditëses t'ia paguajë shumën prej 140 euro, për shpenzimet gjyqësore dhe atë: për taksën për padi 40 euro, dhe për shpenzimet e përpilimit të ekspertizës financiare shumën prej 100 euro.

Nga të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr. 102/18, datë. 24.09.2020

G J Y Q T A R I
Veton Ademaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.